

## **Përgjigje ndaj kërkesës me nr.rendor 2 në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024**

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj lidhur me përcjelljen pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për verifikim ose jo të kontratave të koncesionit me objekt “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Milot-Thumanë”; “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lekaj”; “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier”; “Ndërtim dhe Mirëmbajtje e Aksit Rrugor "Thumanë–Fushë-Krujë–Vorë–Kashar”, si dhe të kontratës “Dhënie me Koncesion/PPP te Projektit te Rrugës Porti i Jahteve - Orikum – Dukat”, ju bëjmë me dije se për sa vijon se Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (në vijim ATRAKO), në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM Nr.575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, asiston dhe nxit Autoritetet Kontraktuese për procedurat e dhënies me koncesion/partneritet publik privat. Janë Autoritetet Kontraktuese përgjegjëse për procedurat e koncesionit, ruajtjen e dokumentacioneve përkatëse, përfshirë këtu dhe kontratat e koncesionit/PPP-së. Thënë kjo janë po këta të fundit sërish përgjegjës për përcjellje të kopjeve të kontratave të koncesionit/PPP-së, ku për rrjedhojë kanë dhe informacionin që kërkohet prej jush.

Ndërkohë për dijeninë tuaj, mbështetur dhe në VKM-në Nr. 211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrin Elektronik të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat”, pranë ATRAKO-s janë përcjellë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si Autoritet Kontraktues në kontratat e listuara prej jush vetëm kopjet e kontratave të koncesionit për “Ndërtim dhe Mirëmbajtje e Aksit Rrugor “Thumanë–Fushë-Krujë–Vorë–Kashar” dhe atë me objekt “Dhënie me Koncesion/PPP te Projektit te Rrugës Porti i Jahteve - Orikum – Dukat”, të aksesueshme online në Regjistrin Elektronik të Koncesioneve, pjesë e faqjen zyrtare ëeb të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, [www.atrako.gov.al](http://www.atrako.gov.al).